



01/Nr. 1131 /2023
Data : 07.02.2023

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2023 e Komitetit për Politikë dhe financa , mbajtur me datë 18.01.2023 me fillim pune ne ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjan** (Nënkryetar i Komunës), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë për Administratë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për buxhet dhe Financa), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), **Bashkim Sopa** (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesi i OSB-së.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për vitin 2022.
3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022-2023.
4. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2023.
5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2023.
6. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.
7. Plani i menaxhimit të mbeturinave.
8. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2022.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim pikën shtesë; rezultati i votimit ishte një zëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin; nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- materialin e keni para vetës por ju njoftoj se nuk jemi të barazuar në thesar sepse barazimi nuk është bërë jo vetëm me komunën tonë por edhe me komunat e tjera . Për mbledhje të kuvendit të komunës ky raport do të përcillet me shumat të sakta.

Refet Kalisi thekson:- shërbimet varrimit a i keni me tjetër kodë apo nuk i keni paraqitur . Furnizim me ushqim dhe pije jo dreka dhe zyrtare i keni të paraqitura këtë shumë. Dreka zyrtare 11320 € . Kërkoj sqarim për mirëmbajtjet investive . Karburantet janë shumë prej 25000 € ndërsa në vitin e kaluar janë 14000 por unë mendoj për shkak të rritjes së çmimeve.

Lindita Ballazhi thekson:-shërbimet e varrimit kryhen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve përkatësisht nga drejtoria për shërbime publike dhe emergjenca. Furnizim me pije e jo dreka zyrtare përfshihen shërbimet e bifesë dhe furnizimet që bëhen për nevojat e çerdhes. Te drekat zyrtare përfshihen manifestimet e ndryshme, dreka të kryetarit të komunës me mysafirë. Mirëmbajtja investive ka të bëjë me investimet kapitale emërtimin në sistemim e buxhetit e ka ky kod por jo të gjitha projektet. Sa i përket karburanteve kemi paguar obligime edhe nga viti i kaluar por ju e dini që janë rritur edhe çmimet .

Sherif Berisha thekson:- në total të buxhetit keni pasur 1, 933, 774.29 € , ndërsa në total i keni shpenzuar 2 600,000.00 €, kurse mjete të pa shpenzuar ju kanë mbetur 248, 685.64 € . Bazuar në këtë raport financiarë për vitin 2022 del që mjete të pa shpenzuara nga granti qeveritarë janë në shumë 91 672.85 € . Te mallrat dhe shërbimet sipas planit kontabël ka shpenzime marramendëse në krahasim me vitin 2021. Te kodi parave të gjepit nuk e keni dhënë asnjë sqarim për shpenzimet. Te kodi 13460 shërbimet kontraktuese 58 402 .83 € . Te drekat zyrtare keni shpenzuar 11,320 € është mirë me sqaruar se për çfarë dreka bëhet fjalë . Nuk ka përputhshmëri te kategoritë e investimeve kapitale .

Lindita Ballazhi thekson:- ashtu siç e ceka në fillim se ende nuk jemi barazuar me ministrinë ndërsa për në kuvend për çdo kategori sqarime do të jenë . Te mallrat dhe shërbimet kemi shlyer obligime mbi 180 000 € duke filluar nga viti 2016 dhe ata obligime janë shlyer pikërisht nga kjo kategori e mallrave dhe shërbimeve . Shpenzimet jashtë vendit sqarimet do të ipen në kuvendë. Për shërbimet kontraktuese do të ipen shpenzimet në kuvend. Drekat zyrtare e potencova që ka të bëjë me manifestime , koktele të ndryshme , mysafir të kryetarit të komunës nga komunat e ndryshme , mirëpo për kuvend në detale do të paraqiten. Te investimet kapitale në fillim është paraqitur buxheti sa është duke u bazuar në bazë të ligjit të buxhetit pastaj kemi pasur donacione të ndryshme në vlerë prej 44 000 € , donacion nga qeveria Japoneze , kemi pasur një grand shtesë prej qeverisë.

Kryesuesi thekson:- keni të drejtë me parashtruar pyetje por paraprakisht drejtoresha më ka njoftuar për shkak se nuk kanë mundur me u barazuar me thesarin por nuk jemi takuar që me ju njoftuar. Drejtoresha ka të drejtë dhe në kuvend besoj që do të përmirësohen.

Refet Kalisi thekson:- shtrimi me kupëza betoni i rrugicave në shumë prej 23905.00 € cilat rrugica janë shtruar. Rregullimi i kanalizimeve në Han të Elezit.

Nexhmedin Daci thekson:- për mbledhje të kuvendit do të ju njoftoj.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINCAIR PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Propozim vendimi për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2022-2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Hisni Luri thekson:- mjetet financiare që ndahen për bursa për studentët janë nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere e cila është në shumë prej 20 000 € për shkak se tash do të përfitojnë 40 studentë sepse kanë qenë 30 . Nga këto 40 studentë dhjetë do të jenë sipas rregullores të ciline keni ndryshuar në vitin e kaluar. Unë mendoj që të shtohet edhe lënda e biologjisë. Nëse keni ndonjë propozim për prioritet mund të parashtroni.

Sherif Berisha thekson:- dhjetë studentët që u potencuan prej Maqedonisë së Veriut a do të jenë të barabartë në kritere.

Hisni Luri thekson:- do të jenë lëndët deficitare dhe do të jenë të barabartë në kritere.

Refet Kalisi thekson:- kriteret në Kosovë janë shumë më të mëdha se në Tetovë dhe mendoj se duhet të kemi prioritet Universitetin Publik të Kosovës që do të thotë që studentët të cilët janë të mirë dhe që studiojnë në Universitetin Publik të Kosovës me pasur prioritet.

Hisni Luri thekson:- ne nuk jemi ata të cilët mundemi me ja përcaktuar nivelin e fakultetit dhe e dimë që Universitetit i Tetovës mund të jetë më i dobët në aspektin e cilësisë në krahasim me Universitetin Publik në Prishtinë por nuk mundemi me ndërhyrë në rregullore.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Plani i punës së këshillave të fshatrave për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Natyra Kalisi thekson:- për hartimin e këtij plani është formuar grupi punues. Sipas planit këshillat fshatrave për vitin 2023 planifikojnë t'i mbajnë gjashtë mbledhje brenda vitit.

Sherfi Berisha thekson:- në takimet të cilat i keni kish dashur të takohem me kryetarin e këshillit të Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherfi Berisha thekson:- kur do të krijohen kushtet për komitetin për persona me aftësi të kufizuara sepse ka anëtarë në këtë komitet në mënyrë që me pasur qasje në objektin e komunës.

Kryesuesi thekson:- besoj që puna e ashensorit do të rregullohet. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- këshilli komunal për siguri në bashkësi për vitin 2023 planifikon t'i mbajë gjashtë mbledhje. Nëse keni ndonjë propozim që mendoj që është i nevojshëm për me qenë në plan mund të propozoni.

Sherfi Berisha thekson:- a është diskutuar çështja e qenve endacak.

Sevdi Dernjani thekson:- ky problem me çështjen e qenve endacak nuk është vetëm në nivel lokal por është edhe në nivel qendror, në KKSBB e kemi diskutuar dhe në nivel qendrorë kemi diskutuar por jemi duke pritur prej nivelit qendrorë për shkak se nuk kemi kapacitet për me eliminuar këtë dukuri. Në takimet e rregullta që i kemi me kryetarët e komunave dhe kryeministrin e Kosovës i kemi diskutuar këtë çështje por nuk kemi marr ndonjë çështje konkrete.

Refet Kalisi thekson:- ky problem është i nivelit qendrorë sepse nuk kemi mjete financiar dhe strehimore për këtë çështje sepse duhet me përkrahur prej Qeverisë. Prishtina e ka bërë dhe besoj që është shembull.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2023 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Plani i menaxhimit të mbeturinave.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Arsim Dernjani thekson:- është bërë prej grupit punues të Komunës në bashkëpunim me Gizin. Këtë plan njëzet e tetë komuna e kanë hartuar. Nëse keni ndonjë propozim mund të parashtroni.

Sherfi Berisha thekson:-menaxhimi i mbeturinave në institucione arsimore dhe komunale është një shumë prej 9292 €, kërkoj sqarim.

Arsim Dernjani thekson:- do të kalon në kuvend dhe në debat publik dhe do t'i japim sqarimet.

Refet Kalisi thekson:- e përgëzoj drejtorin për këtë material dhe dëshiroj që të realizohet.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Majlinda Kaloshi thekson:- në material janë shënuar të gjitha të dhënat në detale dhe nëse keni ndonjë propozim apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- a i kanë paguar bizneset obligimet e veta të cilat i kanë.

Ibadete Kalisi thekson:- për bizneset individuale te gratë çfarë pagese aplikoni.

Majlinda Kaloshi thekson:- nga fillimi kur e kam marr detyrën i kam shpallur edhe borxhin paraprakë. Gjatë vitit të kaluar kemi shpërndarë letër kujtesa përveç aktvendimeve të cilat janë obligative në mënyrë që me ua dhënë mundësinë bizneseve që përmes marrëveshjeve me këste me i kryer obligimet. Te gjinia femërore bizneset lirohen 4 vite prej taksës së ushtrimit të veprimtarisë.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA MBI VEPRIMTARITË E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2023

9. Të ndryshme

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin

Sherfi Berisha thekson:- kërkoj nga Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë një raport të detajuar për çështjen e ujit ? Kërkoj nga Drejtoria e Administratës një raport nga fillimi i vitit për kilometrat për veturat zyrtare? Kërkoj sqarim për çështjen e profesorit të lëndës së Fizikës në shkollë të mesme .

Hisni Luri thekson:- pozita e lirë ka ardhur si rezultat i kontratës që e ka pasur me afat të caktuar nga data 01.09.2021 deri me datë 31.08.2022. Sipas udhëzimit administrativ nuk e ka pasur certifikimin e duhur, pra sipas normativit mbi kuadrin profesional 05/2021 i fuqizuar me datë 18.06.2021 është vërtetuar se nuk e ka certifikimin e duhur dhe nuk i plotëson kriteret . Është hapur konkursi për me rekrutuar një mësimdhënës adekuat sipas kriterëve të përcaktuara te normativi duhet të jetë niveli master 300 kredi, nëse nuk ka nivel me 300 kredi atëherë duhet të shkon te niveli baqellor 240 kredi. Në mungesë të këtyre i nderuari ka pasur fizikë Inxhinierike që i bien me i pasur 180 kredi gjë që i mohohet e drejta për me vazhduar në procedura të rekrutimit. Konkursi i parë ka qenë i hapur me datën 20.07.2022 dhe ka përfunduar me datë 19.08.2022 për shkak se kur shpallen konkurset nga zyrtarja e burimeve njerëzore vetëm afati i njoftimit është një muaj dhe kushteve që kërkohen në bazë të legjislacionit duhet të jenë tre kandidatë që me mundur me i vazhduar procedurat . Në mungesë të kësaj është rishpallur konkursi me datë 15.09.2022 dhe ka vazhduar deri më datë 28.10.2022 përsëri nuk kanë qenë tre kandidatë për me vazhduar me zhvilluar procedurën , ndërsa në konkursin e tretë 07.11.2022 i cili ka përfunduar me 21.12.2022 kanë qenë tre kandidatë dhe në mesin e tyre ka pasur kandidatë që e kanë pasur kualifikimin e duhur. I kemi vazhduar procedurat , mirëpo për shkak të ankesës së tij nëpër gjykata ne duhet ta respektojmë afatin kohorë të përgjigjies së ankesës. Nuk kanë mbetur shumë ditë por për shkak të postës e cila ndoshta mbërrin me vonesë dhe pastaj do të vazhdojmë me i përfunduar procedurat.

Refet Kalisi thekson:- a është duke funksionuar nxemja në QKMF. Në QKMF ishin pranuar disa punëtore të reja dhe është mirë me ju rekomanduar që me pasur sjellje më të mira.

Sherif Berisha thekson:- parkingu te QKMF-ja më ka penguar edhe në pushtetin e më hershëm edhe tash për shkak se po bëhet një katrohurë aty është mirë me bërë një zgjidhje aty që me u liruar trotuari aty


Kimete Kuka - Hasallari thekson:- nxemja është duke funksionuar mirë. Është mirë që për stafin që është i pa përgjegjshëm me parashtruar ankesë në kutinë e ankesave në mënyrë që me pasur fakte për këtë çështje. Prej investimeve kapitale e kemi të planifikuar me rregulluar një ankesë dhe rregullimin e parkut por do ty shikojmë mundësitë për çështje të parkingut.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:31 .

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Komitetit
Florim Shkreta

